

LIGJ
Nr.8209, datë 22.4.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7608, DATË 22.9.1992 "PËR PREFEKTURAT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", neni 1 ndryshohet si vijon: "Prefektura bashkërendon veprimtarinë e shërbimeve të administratës shtetërore në njësitë administrative tokësore të vendit, si dhe kontrollon ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal.

Numri, shtrirja territoriale dhe qendra e prefekturës caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si vijon:

"Prefekti është drejtuesi i prefekturës dhe përfaqësues i Këshillit të Ministrave në njësitë përkatëse administrative tokësore të vendit.

Prefekti mbikëqyr dhe kontrollon shërbimet e administratës civile të shtetit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Prefekti emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit të Brendshëm.

Kandidati për prefekt duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në ligjin "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", të ketë kryer arsimin e lartë dhe të ketë mbushur moshën 30 vjeç".

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Prefekti nuk mund të jetë anëtar i Këshillit të Ministrave. Funksioni i tij është i papajtueshëm gjithashtu edhe me çdo mandat zgjedhor e me çdo funksion tjetër publik a privat, me përjashtim të mësimdhënies".

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Prefekti përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për gjendjen e përgjithshme ekonomike, sociale, arsimore e kulturore të prefekturës, si dhe për zbatimin e politikës shtetërore në njësinë përkatëse administrative tokësore.

Ndërmjet prefektit dhe organeve të zgjedhura të pushtetit lokal nuk ka asnjë marrëdhënie varësie".

Neni 5

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Prefekti ka këto kompetenca kryesore:

1. Kontrollon dhe merr masa për zbatimin e ligjit dhe të vendimeve e akteve të tjera të Këshillit të Ministrave.

2. Kontrollon ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal.
3. Kujdeset dhe merr masa në bashkëpunim me organet e policisë për të garantuar rendin dhe sigurinë publike në njësi territoriale të prefekturës.
Ministri i Brendshëm me udhëzim të veçantë përcakton raportet dhe mënyrën e bashkëpunimit të prefektit dhe drejtuesve të policisë.
4. Kontrollon zbatimin e buxhetit të shtetit në administratën shtetërore e atë të pushtetit lokal, si dhe kujdeset për mirëadministrimin e të gjitha burimeve ekonomike, kulturore, natyrore e historike.
5. Bshkërendon veprimtarinë e shërbimeve të administratës shtetërore në nivel lokal dhe atyre të pushtetit lokal.
6. Koordinon planin për zhvillimin ekonomik, shoqëror, arsimor e kulturor të prefekturës dhe kujdeset për zbatimin e tij.
7. Zgjidh konfliktet e kompetencave ndërmjet organeve të administratës shtetërore në nivel lokal.
8. Nënshkruan në emër të Këshillit të Ministrave marrëveshje me organizma të huaj analogë ose institucione ndërkombëtare, pasi të ketë marrë miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Sekretariatit të Shtetit për Pushtetin Lokal.
9. Propozon për emërimin dhe shkarkimin e sekretarëve të këshillave lokalë dhe drejtuesve të shërbimeve të administratës shtetërore në nivel lokal.
10. Përgjigjet në përputhje me dispozitat ligjore, për përgatitjen dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj fatkeqësive natyrore.
11. Drejton dhe merr pjesë në ceremonitë zyrtare krahas përfaqësuesve të lartë të shtetit.
12. Propozon marrjen e masave disiplinore ndaj drejtuesve të shërbimeve të administratës shtetërore në nivel lokal.
13. Emëron dhe shkarkon nga detyra, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për shërbimin civil" në Republikën e Shqipërisë, personelin e administratës së prefekturës.
14. Në periudha të caktuara, por jo më pak se një herë në vit, informon Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e kryer nga prefektura.
15. Kur e çmon të arësyeshme, si dhe kur i kërkohet, informon organet e administratës qendrore për veprimtarinë e kryer nga shërbimet e administratës shtetërore në prefekturë.
16. Prefekti ushtron edhe kompetenca të tjera që i delegohen nga Këshilli i Ministrave".

Neni 6

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Organet e pushtetit lokal janë të detyruara të njoftojnë prefektin për aktet e nxjerra prej tyre brenda 7 ditëve nga dita e miratimit të aktit, njoftim që vërtetohet me vulën e prefekturës.

Prefekti duhet të shprehet për ligjshmërinë e aktit brenda 10 ditëve nga dita që është njoftuar.

Kur prefekti vëren që një akt i nxjerrë nga pushteti lokal është i paligjshëm, ka të drejtë t'ia kthejë organeve të pushtetit lokal për rishqyrtim ose ta dërgojë atë në gjykatë. Në këto raste pezullohet zbatimi i aktit.

Neni 7

Neni 7 ndryshohet si vijon:

"Në zbatim të kompetencave të tij, prefekti merr vendime dhe nxjerr urdhëra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim.

Konfliktet që mund të lindin ndërmjet ministrave dhe prefektëve për akte të nxjerra nga këta të fundit, zgjidhen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Në zonat që përballen me fatkeqësi natyrore ose edhe situata të jashtëzakonshme që rrjedhin prej tyre, urdhërat e prefektit janë të karakterit normativ për të gjitha institucionet, drejtuesit e të cilëve janë pjesëtarë të shtabit për situata të jashtëzakonshme."

Neni 8

Pas neni 7 shtohet neni 7/a me këtë përmbajtje:

"Prefekti, jo më pak se një herë në muaj, organizon në secilin nga rrethet që përbëjnë prefekturën, mbledhje pune me drejtues të shërbimeve të administratës shtetërore, si edhe të policisë bashkiake e të komunave. Në mbledhje ftohen të marrin pjesë përfaqësues të pushtetit lokal, drejtues të organeve gjyqësore e të prokurorisë, si dhe të forcave të armatosura."

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Pranë çdo prefekturë funksionon këshilli administrativ.

Këshilli administrativ përbëhet nga prefekti, që është edhe kryetar i tij, sekretari i përgjithshëm i prefekturës, kryetarët e këshillave të rretheve, të bashkive dhe drejtuesit e shërbimeve të administratës shtetërore në nivel lokal.

Këshilli administrativ është organ këshillues i prefektit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të prefekturës".

Neni 10

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Këshilli administrativ mbledhet jo më pak se një herë në çdo tre muaj.

Prefekti, kur e çmon të arsyeshme, mund të ftojë në mbledhjet e këshillit edhe persona të tjerë të zgjedhur a funksionarë të pushtetit lokal".

Neni 11

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Këshilli administrativ ndihmon prefektin për përgatitjen e programit vjetor të prefekturës, i cili u njoftohet drejtuesve të organeve të pushtetit lokal dhe të shërbimeve të administratës shtetërore në nivel lokal".

Neni 12

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Kompetencat dhe mënyra e funksionimit të këshillit administrativ caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Prefekti ka kabinetin e tij, të përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme. Struktura e tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave".

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi më 27 prill 1997.

Shpallur me dekreten nr.1785, datë 25.4.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha